



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 11.01.2023  
Nr. Prot 139

**Drejtuar:** PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Adresa:** Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

**KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 4, Tiranë

**AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTAT E**

**ISH SIGURIMIT TË SHTETIT**

Rruga "Dibrës", Tiranë

**AVOKATIT TË POPULLIT**

Bulevardi "Zhan D'Ark", nr. 2, Tiranë

**GJYKATËS KUSHTETUESE**

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 4, Tiranë

**INSTITUTIT TË STATISTIKAVE**

Rruga "Vllazën Huta", Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

**AUTORITETTIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Rruga "Papa Gjon Pali II", nr. 15, KP 1010, Tiranë

**INSPEKTORIATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE  
KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Rruga "Reshit Collaku", Tiranë



**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Godina "Poli i Drejtësisë", Rruga "Ana Komnena", Tiranë

**PROKURORISË SË PËRGJITHSHMË**

Rruga "Qemal Stafa", nr1, Tiranë

**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Rruga e Durrësit nr. 27, Tiranë

**AUTORITETIT TË KONKURENCËS**

Rruga "Sami Frashëri", nr. 4, kati IV, Tiranë 1000

**AUTORITETIT TË MBIKQYRJES FINANCIARE**

Rruga "Kavajës", ndërtesa nr. 27, Hyrja nr.1, Tiranë

**AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Rruga "Myslym Shyri", Tiranë

**AUTORITETIT PORTUAL DURRËS**

Terminali i Pasagjerëve Durrës

**ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË**

Bulevardi "Bajram Curri", Rruga "Viktor Eftimiu", nr.1023, Tiranë

**KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIO DHE TELEVISIONIT**

Rruga "Abdi Toptani", Tiranë

**KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT**

Bulevardi Dëshmorët e 4 Shkurtit, Tiranë

**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Rruga "Abdi Toptani", Nd. 5, Tirana, 1001

**Lënda:** Kujtesë mbi veprimtarinë e institucioneve publike 4 (katër) muaj përpara datës së zgjedhjeve



**Të nderuar drejtues,**

Neni 91 dhe 92 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", përcaktojnë rregulla për veprimtaritë publike të institucioneve në periudhën 4 (katër) muaj përpara datës së zgjedhjeve.

Në kuptim të dispozitave të sipërcituara sjell në **vëmendjen tuaj**, sa më poshtë vijon:

1. Duke filluar nga data 13 Janar 2023 deri në datën 14 Maj 2023, çdo organ publik ka detyrimin të raportojë paraprakisht në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, mbi veprimtaritë publike të kryera nga titullari dhe/ose çdo punonjës i administratës, apo personeli tjetër i institucionit. Këtij detyrimi i nënshtrohen edhe entet e tjerë ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit.
2. Një veprimtari është publike kur ajo do të pasqyrohet sipas rastit në radio, në televizion, në shtyp, në faqe interneti, në median online, në rrjete sociale, ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër që mundëson publikun e gjerë të njihet, apo të informohet mbi atë veprimtari.
3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të njoftohet, për zhvillimin e veprimtarisë publike të paktën 5 (pesë) ditë, përpara datës së parashikuar për zhvillimin e saj. Në rast se, nuk respektohet ky afat veprimtaria do të ndalohej. Veprimtaria e ndaluar nuk mundet të bëhet publike në asnjë nga format e përshkruara në pikën 2, të kësaj kujtese.
4. Njoftimi apo raportimi për veprimtarinë bëhet nëpërmjet ndërfaqes përkatëse të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve <https://aktivitete.kqz.gov.al/>. Për këtë qëllim çdo ent publik ka të hapur në këtë ndërfaqe, një llogari të vetën.
5. Përgjegjës për raportimin është sekretari i përgjithshëm, ose drejtori i përgjithshëm dhe në mungesë të këtyre funksioneve është personi me pozicionin më të lartë administrativ në institucion, përjashtojë titullarin. Personat përgjegjës për raportimin, mundet të autorizojnë





- një person të tretë për raportimin, por në çdo rast janë ata përgjegjës për përmbushjen e këtij detyrimi.
6. Raportimi përmban të dhënat për organin publik që organizon veprimtarinë, datën dhe orën e veprimtarisë, tematikën e veprimtarisë, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin ose jo të veprimtarisë.
  7. Zhvillimi i çdo veprimtarie me karakter publik, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2 të kësaj kujtese, me pjesëmarrjen e punonjësve të organeve publike duhet të raportohen. Ndalohet në këto veprimtari përdorimi i shenjave, logove, sloganeve, pankartave, posterave të lëvizshëm ose jo, materialeve propagandistike që identifikojnë drejtpërsëdrejti, apo tërthorazi një parti politike/subjekt zgjedhor apo kandidat në zgjedhje.
  8. Gjatë zhvillimit të veprimtarive sipas pikës 7, të kësaj kujtese, ndalohen thirrjet, apo fjalimet me përmbajtje partiake ose zgjedhore në favor të një subjekti zgjedhor apo të një kandidati.
  9. Promovimi i investimeve me pjesëmarrjen e zgjedhësve/elektoratit, përfaqësuesve të partisë politike konsiderohet si veprimtari politike zgjedhore. Pjesëmarrja e punonjësve të administratës, brenda orarit zyrtar të punës në këtë lloj veprimtarie, konsiderohet shkelje e dispozitave të Kodit Zgjedhor. Këto lloj veprimtarish me qëllime zgjedhore, ndalohet të publikohen në faqen elektronike zyrtare të institucionit apo në rrjetet sociale zyrtare të institucionit.
  10. Ndalohet promovimi i projekteve të ndryshëm në investime, shërbime, për të cilat fondet janë planifikuar pas datës 13 Janar 2023, dhe jashtë programit vjetor buxhetor të miratuar në fillim të vitit.
  11. Ndalohet shpërndarja publike e lejeve të legalizimit dhe/ose çdo titulli pronësie në periudhën e përcaktuar në këtë kujtesë.
  12. Ndalohet zhvillimi i veprimtarive sikurse përcaktohet në pikën 9 të kësaj kujtese, apo veprimtarive të tjera me karakter politik/zgjedhor në selitë dhe oborret e shkollave, në spitale e të tilla të ngjashme, në selitë e organeve publike qendrore dhe vendore, të tilla si ministri, bashki, agjenci të ndryshme e të tilla të ngjashme.
  13. Ndalohet zhvillimi i veprimtarive sikurse përcaktohet në pikën 9 të kësaj kujtese, apo veprimtarive të tjera me karakter politik/zgjedhor si dhe në biblioteka, qendrat kulturore përveç kur këto janë përcaktuar me vendim/udhëzim nga institucioni që i ka në varësi, si qendra multifunktionale.



14. Titullarët apo personat përgjegjës për drejtimin/administrimin e qendrave multifunksionale, qendrave kulturore dhe ambjenteve sportive duhet të kalendarizojnë paraprakisht vënien në dispozicion në mënyrë asnjëse të ambjenteve për të gjithë subjektet zgjedhore apo kandidatët pa favorizuar asnjë prej tyre.

Për më shumë, mund të konsultoni ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilat mund t’i gjeni të publikuara në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në internet [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al), në rubrikën <Akte>.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

